				e-Albania "Aplikim i formularit për lëshim për herë të parë ose rinovim shërbim elektronik i cili u mundëson qytetarëve të plotësoj për të kryer pajisjen për herë të parë me pasaportë ose për aktuale është lëshuar para datës 31 Dhjetor 2011. e-albania.al Klikoni opsionin “Përdor” dhe plotësoni formularin “Aplikim i formularit për lëshim për herë të parë ose rinovim të pasaportës”. Zgjidhni opsionin "Per femijen" dhe vazhdoni me plotesimin e te dhenave qe u kerkohen. Ju nevojitet ngarkimi i fotografisë se femijes në standardin 4x5cm në formatin jpg, jpeg ose png. Ne rastin kur aplikimi është me procedurë të përshpejtuar (ose aplikim emergjent), nevojitet pervec ngarkimit te fotos, edhe ngarkimi i kopjes së kuponit të procedurës së përshpejtuar. Pas shqyrtimit të aplikimit do të njoftoheni me sms dhe e-mail për miratimin ose jo të procedurës ligjore të kërkuar nga Policia. Pjesë e mesazhit të miratimit do të jetë edhe linku ku duhet të rezervoni datën dhe orën për t’u paraqitur fizikisht me qëllim vijimin e aplikimit. Ditën që do të paraqiteni fizikisht për të vijuar me aplikimin, duhet të keni me vete kuponin dhe femijen. **Kujdes!** Emaili me të cilin jeni i regjistruar në e-albania duhet të jetë aktiv sepse atje do Ju vijë miratimi i aplikimit Tuaj dhe linku për rezervim. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00		

				deri në 19:00. Faleminderit!		
1340	18.10.2022	Kërkesë për informacion për Aplikim për lëshim pronësie , me kosto 1500 Lekë	18.10.2022	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se duhet të aplikoni në e-albania Aplikim për lëshim pronësie , me kosto 1500 Lekë. Ndërsa për të dhënat e pronës duhet te vendosni te sakte zonen kadastrale sic keni ne dokumentin e perfitimit te prones. Ndersa volumin dhe faqet do i plotesoni me 99. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00	E plotë	Nuk ka
1342	18.10.2022	Kërkesë për informacion për ankesen nr. [472191] në Ministrinë e MBROJTJES	18.10.2022	I nderuar.Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se ankesën tuaj lutem niseni në Platformen e Bashkëqeverisjes , ne linkun e mëposhtëm : ME TY PËR SHQIPËRINË QË DUAM - Platforma e Bashkëqeverisjes (shqiperiaqeduam.al) Për cdo pyetje mund te na kontaktoni perseri. Faleminderit !	E plotë	Nuk ka
1343	19.10.2022	Kërkesë për informacion për Pajisjen me liçensë	19.10.2022	Përshëndetje Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se për Tù pajisur me licencën që jeni e interesuar, duhet të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin Aplikim për licencë të re në qendrën kombëtare të biznesit në linkun e mëposhtëm: e-Albania	E plotë	Nuk ka

				e-Albania E-albania është portali qeveritar ku shërbimet publike c sportelet fizike të institucioneve ofrohen në mënyrë ele Qeveritare të Ndërveprimit që ndërlidh sistemet e instit e-albania.al Dokumentacionin pëçdo tip licence e gjeni në linkun e mëposhtëm: Microsoft Word - 3. Aplikim për licencë të re në Qendrën Kombëtare të Biznesit (e-albania.al)		
1344	19.10.2022	Kërkesë për informacion për rinovimin e Çertifikatës së pronësisë	19.10.2022	Përshëndetje Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se kërkesa Juaj është e paqartë. Certifikata e pronësisë nuk rinovohet. Është dokument që lëshohet vetëm një herë dhe përfitohet duke regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës aktin e përfitimit të pronës. Nëse keni objekt në proces legalizimi, dhe kërkoni informacion mbi statusin e procesit, aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin: Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individë dhe persona privatë e publikë në linkun e mëposhtëm:e-Albania	E plotë	Nuk ka

				e-Albania E-albania është portali qeveritar ku shërbimet publike d sportelet fizike të institucioneve ofrohen në mënyrë ele Qeveritare të Ndërveprimit që ndërlidh sistemet e instit e-albania.al Për çdo pyetje e paqartësi na kontaktoni në online chat nga e hëna në të premte, në fashën orare 08.00-19.00 Faleminderit.		
1345	19.10.2022	Kërkesë për informacion për ASHK-në	19.10.2022	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se Ju mund t`i skanoni dokumentet në një dokument të vetëm. Ose ngarkoni vetëm një dokument, dhe në total dërgojini me postë në adresë të ASHK duke vendosur mbi zarf numrin e referencës së aplikimit bashkë me një kopje të mandatpagesës.Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
1346	18.10.2022	Kërkesë për informacion për Rimbusim shpenzimesh për shtetas shqiptare të cilët ndrojnë jetë jashtë shtetit	19.10.2022	Përshëndetje.Në vijim të kërkeses Tuaj për informacion , ju bëj me dije se dokumnetet bashkëlidhur këtij e-mail duhet T'i dërgoni në rrugë postare pranë MIE (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) Duhet patejtër të hapni llogari bankare si një nga kriteret e përcaktuara nga Ministria. Afati ligjor maksimal i përfitimit të këtyre shpenzimeve është 365 ditë , nga dita e largimit nga jeta e personit për të cilin kërkoni rimbursimin e shpenzimeve. Pas ketij afati ju humbet e drejta e perfitimit. Për çdo paqartësi ju lutem kontaktoni 08000118 ose online	E plotë	Nuk ka

				chat nga e hëna në të premte 08.00-19.00. Faleminderit!		
1347	17.10.2022	Kërkesë për informacion për Mbiemrin e fëmijës pa shpallur martesën me babin e fëmijës	19.10.2022	Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se fëmija mer mbiemrin e babit.Vetëm nëse refuzoni atësinë merr mbiemrin tuaj. Lidhja e martesës nuk pengon rregjistrimin e fëmijës në gjendjen Tuaj civile. Babai i fëmijes duhet te jetë prezent ne martenitet në momentin e lindjes se fëmijes , në mënyre që të deklarojë atësine në aktin e lindjes që mbahet në martenitet dhe gjendja civile me pas rregjistron aktin me te gjitha rubrikat e plotesuara ne maternitet . Kur te beni lidhjen e marteses levizni bashke me femijen ne çertfikaten familjare te babait te femijes. Për cdo pyetje mund te na kontaktoni perseri.	E plotë	Nuk ka
1348	17.10.2022	Kërkesë për informacion për Aplikim për pajisje me nënshkrim elektronik për të punësuarit dhe subjektet tatimpaguese .	19.10.2022	Përshëndetje Znj.Bruna, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se Aplikim për pajisje me nënshkrim elektronik për të punësuarit dhe subjektet tatimpaguese . https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13521 e-Albania Dokumentacioni i nevojsh administratës: Për profilin kontributeve për individin portalin e-Albania; - Zgjid elektronik për të punësua e-albania.al	E plotë	Nuk ka

				Ky eshte linku i sherbimit, nese eshte biznes te futet nga llogaria e biznesit.		
1349	16.10.2022	Kërkesë për informacion për vërtetim si individ i parregjistruar	19.10.2022	Përshëndetje Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se Riaplikojeni , pasi vërtetimi vjen për 24 orë. Për cdo pyetje mund te na kontaktoni perseri.Faleminderit !	E plotë	Nuk ka
1350	14.10.2022	Kërkesë për informacion për Shpalljen e martesës	19.10.2022	Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se po eshte e detyrueshme te jeni te dy prezent, dhe ta beni shpalljen ne te dy gjendjet tuaja civile .Duhet patjetër të jetë prezent pasi do shprehi vullnetin e tij të lirë Për cdo pyetje mund te na kontaktoni perseri. Faleminderit !	E plotë	Nuk ka
1351	19.10.2022	Kërkesë për informacion për Aplikim për statusin e certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë	20.10.2022	Përshëndetje Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se: Aplikim për statusin e certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14037 Dokumente që ngarkohen nga aplikanti - Certifikatat e aktivitetit ku ka marrë pjese si brenda dhe jashtë vendit; - Artikujt e botuar në revista të ndryshme shkencore; - Numrin ISBN të librit të botuar; - Vërtetim nga Institucioni/Universiteti/Fakulteti për kurrikulat e përgatitura; - Cdo lloj tjetër dokumenti që vërteton ndjekjen e aktiviteteve të edukimit të vazhduar; - Cdo lloj tjetër dokumenti që lidhet me certifikimin e profesionistëve. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe	E plotë	Nuk ka

				Shoqëror duhet të kryejë procedurat e njohjes dhe regjistrimit të krediteve në dosjen individuale të profesionistit brenda një afati kohor jo më të gjatë se 60 ditë nga data e dorëzimit të dokumentacionit të nevojshëm nga ana e ofruesit ose profesionistit.		
1352	19.10.2022	Kërkesë për informacion për statusin e çertifikimit të profesionistëve të shëndetësisë.	20.10.2022	Përshëndetje ZNJ. Carcani, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se duhet të kontaktoni me QKEV . Ne mund t'ju asistojmë dhe informojmë vetëm lidhur me shërbimet në e-albania. Nëse e keni çertifikatën ku keni marrë pjesë deklarojeni. Aplikim për statusin e çertifikimit të profesionistëve të shëndetësisë. https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14037 Dokumente që ngarkohen nga aplikanti - Certifikatat e aktivitetit ku ka marrë pjese si brenda dhe jashtë vendit; - Artikujt e botuar në revista të ndryshme shkencore; - Numrin ISBN të librit të botuar; - Vërtetim nga Institucioni/Universiteti/Fakulteti për kurrikulat e përgatitura; - Cdo lloj tjetër dokumenti që vërteton ndjekjen e aktiviteteve të edukimit të vazhduar; - Cdo lloj tjetër dokumenti që lidhet me certifikimin e profesionistëve.	E plotë	Nuk ka
1353	20.10.2022	Kërkesë për informacion për gjenerim vërtetim nga e-albania	20.10.2022	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se nga komunikimi me drejtorine e tatimeve na konfirmon se vertetimi nuk u gjenerohet per faktin se rezultoni me detyrime ne vleren 1224 leke.	E plotë	Nuk ka

				Per shtator 2022 ka detyrim 1224 leke.Duhet te besh pagese e ketij detyrimi ne menyre qe te marre vertetimin. Lutem për më shumë informacione kontaktoni : tatime.gov.al Për cdo pyetje mund të na kontaktoni përsëri. Faleminderit !		
1354	14.10.2022	Kërkesë për informacion për Aplikimin e gabuar te nje pagese	20.10.2022	Përshëndetje Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se Ne informacionin tone, pagesa nuk ju kthehet me mbrapsht. Na vjen keq! Për cdo pyetje mund te na kontaktoni përsëri. Faleminderit !	E plotë	Nuk ka
1355	14.10.2022	Kërkesë për informacion për Rregjistrimin si i papunë	20.10.2022	Përshëndetje Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se per te marre vertetimin si punekerkues i papune duhet te aplikoni nga llogaria juaj ne e albania sherbimin ne linkun e meposhtem: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=12544 e-Albania Kontaktet Tel: +355 44 52 Tiranë: Bulevardi "Bajram e-albania.al Nese gjate aplikimit u rezulton se nuk figuroni i regjistruar, duhet me pare te beni regjistrimin ne e-albania si	E plotë	Nuk ka

				punekerkues i papune ne linkun e meposhtem: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=12550, e-Albania Kontaktet Tel: +355 44 52 Tiranë: Bulevardi "Bajram e-albania.al dhe pas nje muaji keni te drejte te pajiseni me Vertetimin si Punekerkues i Papune .Faleminderit		
1356	17.10.2022	Kërkesë për informacion për Vërtetim të pasurisë së paluajtshme nga vendi i Origjinës.	20.10.2022	Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" neni 10, pika "d" përcakton se: "Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar". Si rrjedhojë, gjeni bashkëngjitur kërkesën e mëposhtme, ku znj. Senko kërkon Vertetim posedimi pasuri e paluajtshme nga vendi i origjines Lutemi për një përgjigje drejtuar shqetësimit të znj.Senko.	E deleguar	Nuk ka
1357	20.10.2022	Kërkesë për informacion për Kërkesë për punësim	21.10.2022	Përshëndetje , Për momentin nuk ka vend vakant pranë zyrës tonë -ADISA Fier .	E plotë	
1358	20.10.2022	Kërkesë për informacion për	21.10.2022	Përshëndetje	E deleguar	Nuk ka

		License stomatologjie		Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" neni 10, pika "d" përcakton se: "Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar". Lutem në qartesimini dhe orientonim e Znj.Simoni për plotesimin e formularit për paisje me Licenc për kabinet Stomatologjie.		
1359	20.10.2022	Kërkesë për informacion për Aplikimin AVO	21.10.2022	Përshëndetje .Ne kerkese tuaj per informacion nuk referoni nese keni aplikuar sherbimin AV qe citohet ne shkresen e ASHK.Lutem ,Per tu asistuar lidhur me sherbimin AV0 kontaktoni chat https://www.adisa.gov.al/ ose kontaktoni në 08000118 pa pagesë , për të marë një informacion më të detajuar.	E plotë	Nuk ka
1360	20.10.2022	Kërkesë për informacion për njohjen e patentave të mjeteve lundruese jasht shtetit Shqiptar	21.10.2022	Përshëndetje Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se patenta njihet vetem nga shteti qe e leshon. Nuk ka marreveshje ndershteterore per patentat e lundrimit . Për cdo pyetje mund te na kontaktoni përsëri. Faleminderit !	E plotë	Nuk ka
1361	21.10.2022	Kërkesë e paqartë	21.10.2022	Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se: 1-ne kerkesen Tuaj per informacion nuk cilesoni nese edhe vellai Juaj eshte bashkepronar, dhe per rrjedhoje edhe perfitues me pjese takuese ne kartelen e pasurise 2-Nuk citoni gjithashtu se nga cila llogari ne e-albania eshte bere aplikimi Per te gjitha keto, dhe per me shume informacion e asistence na kontaktoni 08000118	E plotë	Nuk ka

				Faleminderit !		
1362	21.10.2022	Kërkesë për informacion për Lejen e lindjes nga sektori privat	21.10.2022	Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se Adisa nuk ka informacion e kompetence lidhur me kerkesen Tuaj Kontaktoni me drejtorine juridike ne institucionin ku jeni e punesuar Për cdo pyetje mund te na kontaktoni përsëri.	E plotë	Nuk ka
1363	21.10.2022	Kërkesë për informacion për Aplikim per statusin e certfikimit te profeisonisteve te shendetesise	21.10.2022	Përshëndetje Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se duke aplikuar nga llogaria juaj ne e-albania sherbimin:https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14039 dhe me pas apilkoni sherbimin : Aplikim per statusin e certfikimit te profeionisteve te shendetesise : https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14037 Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara në formular; Ju do të njoftoheni me e-mail dhe tek seksioni “Dokumentet e mia” në e-Albania. Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara në formular; Ju do të njoftoheni me e-mail dhe tek seksioni “Dokumentet e mia” në e-Albania. Koha e nevojshme e marrjes së shërbimit Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror duhet të kryejë procedurat e njohjes dhe regjistrimit të krediteve në dosjen individuale të profesionistit brenda një afati kohor jo më të gjatë se 60 ditë nga data e dorëzimit të dokumentacionit të nevojshëm nga ana e ofruesit ose profesionistit.	E plotë	Nuk ka

1364	21.10.2022	Kërkesë për informacion për shpallje martese	21.10.2022	Përshëndetje Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se zonja duhet te beje shpalljen e marteses Certifikata nga akti i lindjes, per te gjitha aktet e mbajtura para vitit 2010 nuk mundesohen ne e-albania. Keto certifikata merren si me poshte: -Per te gjitha rrethet, merret fizikisht ne prefekturen e qarkut . -Per qytetin e Tiranes merret prane Bashkise se Tiranes -Per rrethinat merren prane prefektures se qarkut Tirane	E plotë	Nuk ka
1365	21.10.2022	Kërkesë për informacion për Aplikimin e paasaportes	21.10.2022	Përshëndetje Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se Referuar kerkeses tuaj per informacion , nese keni aplikuar me kupon normal 15 dite eshte afati ligjor i marrjes se sherbimit. Pas shqyrtimit të aplikimit ju do të njoftoheni me sms dhe e-mail per miratimin ose jo të procedurës së kërkuar ligjore nga Policia. - Pjesë e mesazhit të miratimit do të jetë edhe linku ku ju duhet të rezervoni datën dhe orën për t'u paraqitur fizikisht me qëllim vijimin e aplikimit. Ditën që do të paraqiteni fizikisht për të vijuar me aplikimin, ju duhet të keni me vete kuponin që do të duhet ta dorëzoni pranë Zyrës së ALEAT. Nuk ka asnje mundesi As me kupon emergjent nuk aplikon dot, pasi ka nisur procedura e pajisjes me pasaporte me procedure normale Për cdo pyetje mund te na kontaktoni përsëri.	E plotë	Nuk ka
1366	24.10.2022	Kërkesë për informacion për	24.10.2022	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije	E plotë	Nuk ka

		Pension pleqërie		se për të dërguar kërkesën për pension pleqërie, duhet të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin, Aplikim për pension pleqërie, suplementar pilot, suplementar lundrues i nëndetëseve apo suplementar për akademik, në linkun e mëposhtëm:https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=6156 Logohuni me të dhënat Tuaja në e-albania, klikoni linkun e shërbimit, dhe në brendësi të aplikimit do gjeni edhe dokumentacionin e nevojshëm që do të ngarkoni në aplikim. Kujtojmë se dokumentacioni duhet të jetë në format PDF.Theksojmë se dokumenti më i rëndësishëm është libreza e punës, në bazë të së cilës do plotësoni dhe formularin lidhur me vitet dhe qendrat e punës para vitit 1994 dhe pas vitit 1994. Pasi të dërgoni aplikimin, dërgoni dokumentet të cilat i ngarkuat në aplikim me rrugë postare pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, duke vendosur mbi zarf numrin e referencës së aplikimit në e-albania.Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit		
1367	24.10.2022	Kërkesë për informacion për rrehjistrimin e fëmijes së lindur jashtë vendit	24.10.2022	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se fëmijen e lindur jashtë vendit mund ta regjistroni nëpërmjet shërbimeve konsullore duke aplikuar nga llogaria e prindit të fëmijes në e-albania shërbimin: Aplikim për regjistrim fëmije, në linkun e mëposhtëm:https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9767Nëse nuk do veproni nëpërmjet rrugës së mësipërme po Ju dërgojmë dhe procedurën e regjistrimit të fëmijës nëpërmjet të afërmëve si më poshtë vijon:Në pamundësi të paraqitjes së prindërve pranë zyrave të Gjendjes Civile të Njësisë suaj Administrative për të bërë regjistrimin e fëmijës	E plotë	Nuk ka

				së lindur jashtë shtetit, në regjistrin kombëtar të popullsisë në Shqipëri dhe rrjedhimisht edhe në certifikatën tuaj familjare, duhet të dërgoni pranë familjarëve tuaj këto dokumenta:· ***Prokurë e Posaçme për personin që do të kryejë regjistrimin dhe kopje të letërnjoftimeve elektronike të dy prindërve;·*** ***Aktin e lindjes të mbajtur jashtë shtetit, i cili duhet të jetë legalizuar me vulë Apostile dhe i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.*** Në vijim prindi, ose personi i autorizuar, pajiset me Regjistrimin e aktit të lindjes, Certifikatën e aktit të lindjes, Certifikatën familjare dhe Certifikatën personale të të porsalindurit. Në përfundim të regjistrimit të të porsalindurit, me qëllim përftimin e bonusit, nëpunësi i gjendjes civile pajis prindërit me 2 (dy) certifikata, përkatësisht: Certifikatë famjiljare dhe Certifikatë lindje e të porsalindurt, më shënimin "Për bonusin e lindjes".Duhet theksuar në Prokurën e Posacme që personi autorizohet të bëjë regjistrimin e fëmijës, të kryejë tërheqjen e çekut të bebes, dhe tërheqjen e lekëve në bankë.Prokura e posaçme lëshohet nga nëna e fëmijës, pasi edhe çeku emetohet nga Shërbimi Social Shtetëror në emër të nënës.Tërheqja e çekut bëhet pranë Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shteteror.Në rastet e bashkëjetesës, fëmija regjistrohet në gjendjen civile ku është e regjistruar nëna e fëmijës, dhe për rrjedhojë figuron në certifikatën familjare të nënës, jo të babait.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
1368	24.10.2022	Kërkesë për informacion për lidhjen e martesës me shtetas të huaj	24.10.202	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se hapi i parë për lidhjen e martesës, është **shpallja e martesës.** **-Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj,**	E plotë	Nuk ka

				Nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet për shpalljen e martesës, të legalizuar, përkthyer, noteruar: 1. certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e gjendjes civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile; 2. dokumentin / certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese); 3. dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj; 4. fotokopje e dokumentit të identifikimit; Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILLE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noteruar.Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). **Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm:** 1. **certifikatë lindje;** 2. **certifikatë lindje me shënimin "për lidhje martese";** Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare. Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikatë martese/ekstrakt akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e gjendjes civile në Shqipëri në zyrën e gjendjes civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin.		

				Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
1369	25.10.2022	Kërkesë për informacion për Certifikatë rezidence tatimore (biznes)	25.10.2022	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të marrë dokumentin që kërkoni, duhet të aplikoni nga llogaria e biznesit në e-albania shërbimin, Certifikatë Rezidence Tatimore (biznes), në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13203 *Për këtë shërbim nuk kërkohet dokumentacion shoqërues.* Hapat e procedures - Identifikohuni si biznes në portalin e-Albania;- Zgjidhni shërbimin "Certifikatë Rezidence Tatimore";- Klikoni butonin "Përdor";- Zgjidhni shtetin ku do të depozitohet certifikata e rezidencës;Zgjidhni vitin fiskal për të cilën kërkohet certifikata e rezidencës;- Klikoni butonin "Shkarko dokumentin e vulosur" për të gjeneruar certifikatën me vulë elektronike.Certifikatën e gjeneruar me vulë elektronike mund ta gjeni në çdo kohë në seksionin "Dokumentet e mia" te hapësira juaj në portalin e-Albania.Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.	E plotë	Nuk ka
1370	25.10.2022	Kërkesë për informacion për vërtetim për transaksionet me pronen për vitet e fundit	25.10.2022	Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të marrë vërtetim për transaksionet me pronen për vitet e fundit, duhet të aplikoni shërbimin **"Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë)"** përmes platformës qeveritare e-Albania, në linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477 Fillimisht duhet të hartoni një kërkesë me shkrim, ku të sqaroni	E plotë	Nuk ka

				arsyet e përdorimit të këtij dokumenti. Kjo kërkesë duhet të firmoset nga ana juaj dhe të skanohet. Ajo do të ngarkohet në hapin e tretë të formularit në e-Albania ne format pdf. Për të përdorur shërbimin, klikoni *"Përdor"* në fund të faqes dhe vijoni me plotësimin e formularit elekronik. Klikoni butonin *"Dërgo"* në faqen e fundit të formularit. Në hapin e dytë ku u kërkohen të dhënat e pronës, vendosni një zonë kadastrale të qytetit për të cilin do aplikoni, ndërsa volum dhe faqe plotësojini me 99. Këto të dhëna janë vetëm për të orientuar sistemin.Numri i referencës së aplikimit do ju ndihmojë për të gjurmuar aplikimin dhe ngarkuar mandatpagesën.Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë për të kryer pagesën, ose kryeni pagesën online përmes portalit e-Albania me një kartë debiti ose krediti. Nëse pagesa kryhet në bankë ose postë, duhet që t`i riktheheni edhe njëherë aplikimit për të ngarkuar mandatpagesan.**Ngarkimi i mandatpagesës:**Duhet të logoheni në e-Albania dhe të kërkoni shërbimin e aplikuar. Nuk do të kryeni aplikim të ri por do të shkoni në fund të formularit, në seksionin *"Dërgo mandat-pagesën e një aplikimi të kryer"*. Plotësoni të gjitha fushat, numrin e referencës së aplikimit e gjeni edhe tek *"Mesazhet e mia"*, ngarkoni faturën dhe më pas klikoni "*Dërgo"*		
1371	25.10.2022	Kërkesë për informacion për Një dosje me proçes legalizimi	25.10.2022	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të marrë informacion për çështjen që referoni në kërkesën për informacion, aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin: Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë), ne linkun e meposhtem: **https://e-**	E plotë	Nuk ka

				albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477 **Fillimisht duhet të hartoni një kërkesë me shkrim, ku të sqaroni arsyet e përdorimit të këtij dokumenti në lidhje me dosjen në proces legalizimi . Kjo kërkesë duhet të firmoset nga ana Juaj dhe të skanohet në formatin PDF . Kërkesa do të ngarkohet në hapin e tretë të aplikimit të shërbimit në e-Albania.** **Për të përdorur shërbimin, klikoni "Përdor" në fund të faqes dhe vijoni me plotësimin e formularit elekronik.** Pavarësisht se Ju nuk keni të dhëna prone, për të orientuar sistemin duhet të vendosni një zonë të saktë kadastrale, ndërsa volumin dhe faqen i vendosni 99. Zona kadastrale duhet të jetë zona që përfshin zonën ku ndodhet objekti Juaj. Klikoni butonin "Dërgo" në faqen e fundit të formularit. Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë ose në poste për të kryer pagesën, si dhe depozitimin me poste të kërkesës që keni bashkëlidhur aplikimit dhe mandatin e pagesës që do të kryeni. Agjencia Shtetërore e Kadastrës do T`Ju pajisë me informacionin që kërkoni. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
1372	25.10.2022	Kërkesë për informacion për Aplikim pasaporte	25.10.2022	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion ,Ju bëjmë me dije se pas shqyrtimit të aplikimit duhet të njoftoheni me sms dhe e-mail brenda 7 ditëve për miratimin ose jo të procedurës ligjore të kërkuar nga Policia. Pjesë e mesazhit të miratimit do të jetë edhe linku ku duhet të rezervoni datën dhe orën për t'u paraqitur fizikisht me qëllim vijimin e aplikimit. Ditën që do të paraqiteni fizikisht për të vijuar me aplikimin, duhet të	E plotë	Nuk ka

				keni me vete kuponin dhe pasaportën aktuale që do të duhet ta dorëzoni pranë Zyrës së ALEAT. Duke qenë se Shërbimet e Policisë së Shtetit në e-albania kohët e fundit kanë shfaqur problematika, lutemi të gjurmoni statusin e aplikimit nëse rezulton përfunduar apo në proces. Nëse rezulton përfunduar, rezervoni takimin tek Aleat dhe vazhdoni me procedurën. Nëse rezulton ende në proces, lutem të paraqiteni në sportelet e Komisariatit të policisë të lagjes Tuaj. **Kujdes!** Emaili me të cilin jeni i regjistruar në e-albania duhet të jetë aktiv sepse atje do Ju vijë miratimi i aplikimit Tuaj dhe linku për rezervim.Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
1373	25.10.2022	Kërkesë për informacion për Volumin , faqen e zones kadastrale	25.10.2022	PërshëndetjeNë vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se a keni bërë apilkim ? Në rast se dispononi zonën kadastrale dhe volum dhe faqe jo , s içua shpjegon dhe sistemi do të proçedoni me 9-ta . Te Volumi 99-të dhe faqe 99-të.	E plotë	Nuk ka
1374	25.10.2022	Kërkesë për informacion për Aplikim licence e re	25.10.2022	Përshëndetje Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se : Aplikim për licencë të re në Qendrën Kombëtare të Biznesit https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx? Në linkun e dytë keni dokumentacionin në fund far : https://e-albania.al/eAlbaniaServices/QKB/4607/qkb_4607_dokumentacioni.pdf	E plotë	Nuk ka
1375	25.10.2022	Kërkesë për informacion për aplikim për ndryshim të	25.10.2022	Përshëndetje Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se aplikim për ndryshim të regjistrimit të Personit Fizik https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=	E plotë	Nuk ka

		regjistrimit të Personit Fizik		4965ky eshte linku i sherbimi Shërbimi elektronik për ndryshim të regjistrimit të Personit Fizik u ofrohet subjekteve që kanë një llogari në portal. Për të kryer aplikimin për ndryshim të regjistrimit të Personit Fizik, subjekti aplikon duke plotësuar formularin përkatës për ndryshim të regjistrimit të Personit Fizik. Mbështetur në nenin 43 të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, çdo subjekt, që kryen regjistrimin fillestar, mbart edhe detyrimin të regjistrojë çdo ndryshim në të dhënat e njoftuara dhe në dokumentet shoqëruese, që depozitohen në regjistër, sipas seksionit III të këtij ligji. QKB-ja, pasi kryen verifikimet përkatëse, sipas nenit 54 të këtij ligji dhe vëren përmbushjen e kushteve për regjistrim, kryen regjistrimin në regjistër dhe lëshon vërtetimin e kryerjes së regjistrimeve të tjera brenda një afati prej një dite nga data e paraqitjes së aplikimit. Per detaje te metejshme ti drejtohet QKB pasi nuk eshte me ne kopetencen tone dmth nuk e kemi si informacion per ceshtjen e dokumentave		
1376	26.10.2022	Kërkesë për informacion për Epikrizën e aftësisë ose paaftësisë	26.10.2022	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për çështjen që referoni duhet të drejtoheni tek mjeku specialist. Është mjeku specialist që u pajis me epikriën e aftësisë apo paaftësisë, e më pas u pajis me fletë drejtimi për në KMCAP (Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë)Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
1377	26.10.2022	Kërkesë për informacion për mbyllje pensioni	26.10.2022	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bejme me dije se duhet të aplikoni në e-albania shërbimin	E plotë	Nuk ka

				"Mbyllje pensioni", nëse i ndjeri ka qenë pensionist. Për të bërë mbylljen e pensionit, duhet të aplikoni nga llogaria ndonjë familjari në e-albania shërbimin" Aplikim për mbyllje pensioni" në linkun e mëposhtem: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=6162 **Hapat e procedurës** - Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania - Zgjidhni shërbimin "Aplikim për mbyllje pensioni" - Klikoni butonin "Përdor" - Plotësoni formën përkatëse për këtë kërkesë dhe dërgoni aplikimin. - Dokumentet origjinale që i keni bashkëlidhur gjatë aplikimit duhet të dërgohen me postë pranë DRSSH përkatëse. Ju lutem mbani në konsideratë që zarfi i përcjelljes së këtyre dokumenteve të shoqërohet me numrin e aplikimit tuaj. Pamvarësisht se me cilin ligj e keni përfituar pensionin, për mbylljen e tij aplikohet vetëm në këtë link. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
1378	26.10.2022	Kërkesë për informacion për Shpallje martese	26.10.2022	Përshëndetje Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se : Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesa.	E plotë	Nuk ka

				Dokumentet e nevojshëm për shpalljen e martesës janë: prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes; certifikatë lindje, me shënimin “për shpallje martese”; fotokopje e dokumentit të identifikimit; [Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Nëse martesa do të lidhet në një shtet të huaj, pas kalimit të afatit 10 ditor nga shpallja e martesës, duhet të pajisen me këto dokumente: certifikatë lindje; certifikatë lindje, me shënim “për lidhje martese”; Këto dokumente duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për të ndjekur më pas procedurën e lidhjes së martesës sipas legjislacionit të vendit të huaj ku bashkëshortët e ardhshëm kanë vendqëndrimin. Aplikimet për legalizim kryhet në zyrat e Postës Shqiptare.		
1379	26.10.2022	Kërkesë për informacion për gjenerimin e të dhënave	26.10.2022	Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nese nuk arrini te logoheni (futeni) ne llogarine Tuaj ne e-albania, nese nuk keni aktive asnje nga te dhenat e regjistrimit(adrese email dhe numer telefoni) per te gjeneruar nje pasword te ri duhet te veproni si me poshte: Hapni nje adrese te re email dhe dërgoni këto të dhëna në adresën: helpdesk@e-albania.al : - foto te kartës ID - emri i nënës - emri i babait - datëlindja e nënës	E plotë	Nuk ka

				Specifikoni adresën e re email që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal.		
1380	26.10.2022	Kërkesë për informacion për Akreditim të institucionit shëndetësor	26.10.2022	Përshëndetje Z/ZNJ Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se aplikim për akreditim të institucionit shëndetësor https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=947&service_type=Y Ne ju dergojme linkun e sherbimit , dhe per dokumentacionit duhet te lexoni ne brendesi te sherbimit.Për cdo pyetje mund te na kontaktoni përsëri.	E plotë	Nuk ka
1381	28.10.2022	Kërkesë për informacion për Prokurë të posacme	28.10.2022	Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion ,Ju bëjmë me dije se pasi keni kryer aplikimin për prokurë të posaçme nga llogaria Juaj në e-albania, me anë të e-mail-it të plotësuar në rubrikën përkatëse, do t'Ju dërgohet konfirmimi i aplikimit si dhe kodi i veçantë i aplikimit (i cili mundëson ndjekjen e ecurisë së aplikimit në çdo moment) - Ndiqni procedurat për të kryer pagesën dhe për të dërguar mandatin origjinal (jo fotokopje) me postë - Qytetari është i detyruar të paraqitet në përfaqësi për të firmosur në prezencë të konsullit procesverbalin e dorëzimit të kërkesës dhe për të dorëzuar dokumentat origjinale. **Koha e nevojshme e marrjes së shërbimit** 120 ditë Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat, nga e Hëna	E plotë	Nuk ka
1382	28.10.2022	Kërkesë për informacion për Tu pajisur me nënshkrim elektronik	28.10.2022	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për T`u pajisur me nënshkrim elektronik, nga llogaria e administratorit në e-albania duhet të aplikoni shërbimin Aplikim për pajisje me nënshkrim elektronik për të punësuarit dhe subjektet tatimpaguese në linkun e mëposhtëm: https://e-	E plotë	Nuk ka

				albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13521 Nënshkrimi Elektronik, janë të gjitha të dhënat në formë elektronike, të cilat u bashkëlidhen ose shoqërojnë logjikisht të dhëna të tjera elektronike, që shërbejnë si një mënyrë e vërtetimit të identitetit të nënshkruesit dhe vërtetësisë së dokumentit të nënshkruar. Aplikimi për Nënshkrimin Elektronik mund të kryhet për profilet e mëposhtme: - Profesionist i lirë - Profesionist i punësuar - Administrator - Drejtues Teknik Lutemi të tregoni kujdes në të dhënat e vendosura në aplikimin tuaj për nënshkrimin elektronik pasi bazuar në ligjin Nr. 9880, datë 25.02.2008, neni 25, pika 2, këto të dhëna duhet të konfirmohen nga organet përgjegjëse për lëshimin e tyre. Në raste pasaktësie të dhënash si: - Plotësimi i gabuar i numrit të licencës - Plotësimi i gabuar i institucionit lëshues - Licencën e ushtrimit të profesionit e parinovuar ose joekzistente *Shuma e plotë e shërbimit do të tarifohet dhe nuk mund t'ju rimbursohet!* Mandat Pagesa duhet të përmbajë të dhënat e aplikantit (Emër Mbiemër) dhe jo të dhënat e subjektit që ai përfaqëson si NIPT ose Emër subjekti!		
1383	28.10.2022	Kërkesë për informacion për ndryshimin e vendbanimit	28.10.2022	Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se per te bere ndryshimin e vendbanimit, do te logoheni me te dhenat Tuaja ne e-albania dhe do te aplikoni sherbimin "Aplikim per ndryshim/Saktesim Vendbanimi" ne linkun e meposhtemhttps://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14419Ne aplikim do ngarkoni ne format PDF nje nga dokumentet e meposhtme:Kopje te noteruar te certifikates se pronesiseKontrate noteriale qerajeAkt noterial perdorimi	E plotë	Nuk ka

				baneseFushat qe jane me * jane te detyrueshme per t`u plotesuar. **Lidhur me problemin që referoni se tek opsioni i adresës nuk u shfaqet adresa Juaj, lutemi kontaktoni sektorin e urbanistikës pranë Njësisë Tuaj Administrative.**Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
1384	28.10.2022	Kërkesë për informacion për Vërtetimin e DPT	28.10.2022	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se për të marrë vërtetimin që kërkoni, hartoni një kërkesë me shkrim dhe dërgojeni në adresë të (DPT) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet shërbimit postar.	E plotë	Nuk ka
1385	28.10.2022	Kërkesë për informacion për Vertetimin e banimit	28.10.2022	Përshëndetje Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se vertetimin qe nuk merr pension ketu e ben me ane te nje kerkese me shkrim prane postesVertetim per vendbanimin e merr nga njesia ose bashkia ku jeton Certifikate personale ose familjare ku tregon statusin e zonjes qe eshte e ve ne E- Albania dhe nje certifikate vdekjet per te ndjerin	E plotë	Nuk ka
1386	28.10.2022	Kërkesë për informacion për leje përdorim	28.10.2022	Përshëndetje Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se ky sherbim nuk ofrohet ne e-albania ,do ta merrni fizikisht prane Bashkise.	E plotë	Nuk ka
1387	28.10.2022	Kërkesë për informacion për celebrim	28.10.2022	Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesa.Dokumentet e nevojshëm për shpalljen e martesës	E plotë	Nuk ka

				janë:prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes;certifikatë lindje, me shënimin “për shpallje martese”;fotokopje e dokumentit të identifikimit; Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, secili nga bashkëshortët e ardhshëm pajiset me dokumentin certifikatë lindje për lidhje martese. Në ditën e caktuar për lidhjen e martesës duhet të jenë të pranishëm dhe dy deshmitare		
1388	28.10.2022	Kërkesë për informacion për shpallje martese kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent	28.10.2022	Përshëndetje Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesa.Dokumentet e nevojshëm për shpalljen e martesës janë:prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes se masrteses ; certifikatë lindje, me shënimin “për shpallje martese”; fotokopje e dokumentit të identifikimit;Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit.Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, secili nga bashkëshortët e ardhshëm	E plotë	Nuk ka

				pajiset me dokumentin certifikatë lindje për lidhje martese. Në ditën e caktuar për lidhjen e martesës duhet të jenë të pranishëm dhe dy deshmitare.		
1389	28.10.2022	Kërkesë për informacion e paqartë	28.10.2022	Përshëndetje Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se ju lutem ma formuloni qarte kerkesen tuaj per informacion.	E plotë	Nuk ka
1390	28.10.2022	Kërkesë për informacion për Certifikatat e Trungut Familjar	28.10.2022	Përshëndetje Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se Ju bëjmë me dije se Certifikatat e Trungut Familjar nuk mundesohen ne e-albania. Per keto certifikata, procedohet si me poshte:Per qytetaret e Tiranes, certifikatat merren tek Bashkia Tirane. Per rrethinat e Tiranes merren tek Prefektura Tirane. Per te gjitha Bashkite e Komunat e tjera ne territorin e Shqiperise, certifikatat merren prane Prefekturave te Qarqeve respektive.	E plotë	Nuk ka
1391	28.10.2022	Kërkesë për informacion për rivlerësim pasurie	28.10.2022	Përshëndetje , po jú kontaktojmë në telefon. Ju faleminderit!	E plotë	Nuk ka
1392	31.10.2022	Kërkesë për informacion për Aplikim per informacion zyrtar te pasurise per individe dhe persona juridik(private dhe publike)	31.102022	Përshëndetje Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se ju keni zgjedhur sherbimin e gabuar, per sherbimin Aplikim per informacion zyrtar te pasurise per individe dhe persona juridik(private dhe publike) klikoni ne linkun e me poshtem. Paraprakisht beni nje kerkese me shkrim per ta ngarkuar gjate aplikimit.	E plotë	Nuk ka
1393	31.10.2022	Kërkesë për	31.10.2022	Përshëndetje Z/ZNJ	E plotë	Nuk ka

		informacion për Vertetimin me vule elektronike		Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se Vertetimi me vule elektronike gjenerohet menjehere online per cdo person te punesuar apo te vetepunesuar per vitet e punes nga viti 2012 deri me sot .https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14946		
1394	31.10.2022	Kërkesë për informacion për aplikim për kërkesë për fitim shtetësie	31.10.2022	Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të aplikuar për kërkesë për fitim shtësie, nuk është e nevojshmë të jeshë e regjistruar në e-albania. Ky shërbim është për shtetasit e huaj dhe për rrjedhojë aplikophet pa u loguar me të dhënat personale. Duhet të aplikoni shërbimin Kërkesë për fitim shtetësie, në linkun e mëposhtëmhttps://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9627Ndërsa në linkun e mëposhtëm gjeni dokumentacionin e nevojshem për secilin tip aplikimihttps://e-albania.al/eAlbaniaServices/DPPSH/9627/9627_dokumentacioni.pdfKërkesa Juaj për fitim shtësie i përket kategorisë, Kërkesë për fitim të shtetësisë me natyralizëm nga të huajt e martuar me shtetas shqiptarHapat e procedures - Zgjidhni shërbimin "Kërkesë për fitim shtetësie";- Klikoni butonin" Përdor";- Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara në formular;- Ngarkoni në formatin PDF të gjithë dokumentet e listuara në fomular;- Klikoni butonin “Dërgo” në fund të formularit;- Punonjësi i Policisë së Shtetit njoftohet elektronikisht për mbërritjen e dosjes se re dhe nis të verifikojë saktësinë e dokumenteve;- Nëse dokumentet janë të plota, qytetari njoftohet për të dorëzuar fizikisht dokumentet origjinale;- Nëse ka pasaktësi ose mungesë dokumentesh, punonjësi i DPPSH-së njofton aplikantin për pasaktësitë dhe e udhëzon për të riplotësuar praktikën e aplikimit;- Aplikanti paraqitet në Zyrë e Shërbimit të Qytetarit (ZSHQ) në orarin e caktuar nga	E plotë	Nuk ka

				punonjësi i ZSHQ-së përkatëse.- Punonjësi i ZSHQ-së përfundon kërkesën.Koha e nevojshme e marrjes së shërbimit 6 muajPër cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.		
1395	31.10.2022	Kërkesë për informacion për për të plotësuar një AV	31.10.2022	Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të plotësuar një AV, ose e quajtur ndryshe "Akt Verifikimi" duhet të logoheni me të dhënat tuaja në e-Albania dhe më pas të kërkoni shërbimin që ju keni aplikuar së fundmi. Pra shërbim për të cilin do të plotësoni dokumentacionin me AV.Pas kërkimit të shërbimit duhet të klikoni **"Përdor"** dhe më pas do të vazhdoni në fund të faqes ku do të gjeni një tabelë me këtë pamje ; Pasi të plotësoni të dhënat e mësipërme, klikoni butonin **"Dërgo".** Ky dokument (AV) është kërkesa ose shkresa juaj që do ia drejtoni ASHK-së.	E plotë	Nuk ka
1396	31.10.2022	Kërkesë për informacion për Mos logimin në e-albania	31.10.2022	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse nuk arrini të logoheni (futeni) ne llogarine Tuaj ne e-albania, nese nuk keni të sakta asnjë nga të dhënat e regjistrimit(adresë email dhe numër telefoni) për të gjeneruar një pasword të ri duhet të veproni si më poshtë:Nga adresa e saktë email, dërgoni këto të dhëna në adresën :helpdesk@e-albania.al .Duke bashkëlidhur këto të dhëna - foto te kartës ID - emri i nënës - emri i babait - datëlindja e nënës Specifikoni adresën email që doni të përdorni në vazhdim për	E plotë	Nuk ka

				llogarinë tuaj në portal.Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.		
1397	31.10.2022	Kërkesë për informacion për të kërkuar legalizimin e ndërtimit pa leje	31.10.2022	Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të kërkuar legalizimin e ndërtimit pa leje, duhet të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin, **Kërkesë për legalizim të ndërtimit pa leje, në linkun e mëposhtëm.** https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14542 Dokumentet që duhet të ngarkoni në aplikim dhe më pas T`i dërgoni me rrugë postare pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës janë:1. Foto të objektit në të katër pozicionet2. Plan rilevimi3. Certifikatë familjarePër ëdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit	E plotë	Nuk ka
1398	31.10.2022	Kërkesë për informacion për Të dhënat në e-albania	31.10.2022	Përshëndetje Z/ZNJ Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se Kjo s'ka lidhje me ne, dërgo email në adresën helpdesk@e-albania.al në lidhje me problematikën tuaj Për cdo pyetje mund te na kontaktoni përsëri.	E plotë	Nuk ka
1399	31.10.2022	Kërkesë për informacion për akreditim	31.10.2022	Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se Ne vijim te kerkeses Tuaj per informacion ju bejme me dije se duhet te regjistroheni ne programin e certifikimit. per kete duhet te aplikoni nga llogaria Juaj ne e-albania sherbimin.Aplikim për regjistrimin në programin e certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë	E plotë	Nuk ka
1400	31.10.2022	Kërkesë për informacion për çertifikimin e profesionistëve	01.11.2022	Përshëndetje Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se per te mare informacion mbi kreditet duhet te	E plotë	Nuk ka

